



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade
Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

SKEMA E GRANTEVE

Udhëzues për aplikim: Thirrja publike për përkrahjen financiare të ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) për certifikim të produkteve.

Autoriteti kontraktues dhe zbatues: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), respektivisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA).

1. Qëllimi

MINT përmes Agjencisë KIESA, lanson skemën e granteve për mbështetjen e NMVM-ve, e cila ka për qëllim t'i mbështet ndërmarrjet për certifikim ndërkombëtar të produktit, me qëllim të rritjes së eksportit të mallrave dhe shërbimeve. Kjo skemë mbështetë certifikimet ndërkombëtare të cilat nuk mund të realizohen në Kosovë. Inkurajohen ndërmarrjet që kërkojnë certifikim ndërkombëtar për produktet që përmbajnë karakteristika të qëndrueshmërisë mjedisore ose të ekonomisë qarkore, duke përfshirë përmbajtje të riciklueshme, dizajn të qëndrueshëm ose përdorim të burimeve të rinovueshme. Kjo për arsye se produktet inovative dhe me karakteristika të gjelbra dhe qarkore janë gjithnjë e më të kërkuara në tregjet ndërkombëtare.

2. Sektorët

Të drejtë aplikimi kanë NMVM-të nga të gjithë sektorët, produktet e të cilëve kanë nevojë për certifikim ndërkombëtarë të tyre.

3. Përkrahja financiare e ofruar nga MINT/KIESA

Shuma totale e skemës së grantit është 600,000.00€. MINT/KIESA rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet e disponueshme. Grantet do të ndahen për NMVM-të, me një vlerë maksimale deri në 25,000€ për përfitues. Çdo tejkallim i kësaj vlere duhet të mbulohet nga vetë ndërmarrjet përfituese.

4. Dokumentet e kërkuara për aplikim sipas Udhëzimit Administrativ 01/2018

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.
2. Certifikatën e numrit fiskal (nuk aplikohet për ndërmarrjet të cilat numrin e regjistrimit të biznesit dhe numrin fiskal e kanë në një certifikatë).
3. Vërtetim tatimor me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK.
4. Listën e punëtorëve për vitin 2024 të lëshuar nga ATK me emrin e biznesit aplikues në harmoni me NUI (mund të nxjerrët online nga ueb faqja e ATK-së). Në bazë të listës do të kategorizohen dhe vlerësohen NMVM-të. Për ndërmarrjet e regjistruara gjatë vitit 2024 dhe 2025 duhet të sjellin listën e punëtorëve që nga regjistrimi.

5. Kopjen e letërnjoftimit të personit/ve në emër të cilit/ve është i regjistruar aplikuesi.
6. Dëshmi nga aplikuesi se nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Themelore - kërkohet origjinali jo më i vjetër se 30 ditë. Dokumenti mund të nxirret në Gjykatën Komerciale të Kosovës.
7. Dëshminë e xhirollogarisë aktive në emër të biznesit aplikues në njëren prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës. Dëshmia duhet të jetë brenda afatit të hapjes së thirrjes.
8. Gjendjen e xhirollogarisë bankare në emër të biznesit aplikues për vitin e fundit (2024). Për aplikuesin e sapo themeluar kjo nuk është e aplikueshme.
9. Projekt propozimi duhet të përfshijë: qëllimin, aktivitetet e projektit, koston financiare, planin kohor dhe profesional të realizimit të projektit mbi certifikimin ndërkombëtar të produktit përfshirë këtu potencialin për zgjerimin e tregut, ku synohet eksporti, si dhe strukturën organizative të aplikuesit dhe objektivat e kompanisë. Projekt propozimi duhet të përgatitet nga subjekti aplikues dhe të ngarkohet në platformën e-Kosova.
10. Oferta të jetë në emër të ndërmarrjes, nga një trupë e vlerësimit të konformitetit (i notifikuar ose i akredituar) ku do ta certifikoj produktin, që është i akredituar nga një trupë akredituese i një shteti.
11. Të mos ketë pranuar mjete nga burimet tjera të financimit për të njëjtat aktivitete (e dëshmuar me deklaratë nën betim, e cila duhet shkarkuar nga ueb faqja e KIESA-se, të plotësohet me të dhënat e biznesit dhe e njëjta të ngarkohet në sistemin e-Kosova).
12. Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit nga MINT për dy vitet e fundit, (e dëshmuar me deklaratë nën betim, e cila duhet shkarkuar nga ueb faqja e KIESA-se, të plotësohet me të dhënat e biznesit dhe e njëjta të ngarkohet në sistemin e-Kosova).
13. Për ndërmarrjet e regjistruara para vitit 2024, duhet të sjellin qarkullimin për vitin 2024, i dëshmuar me dokument të lëshuar nga ATK. Për ndërmarrjet e regjistruara gjatë viteve 2024 dhe 2025 duhet të sjellin qarkullimin total që nga regjistrimi.
14. Aplikacioni dhe buxheti, të plotësohen online në e-Kosova.

5. Sqarime shtesë

- Aplikimet pranohen në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.
- NMVM-të që gjatë vitit 2023 dhe 2024 kanë përfituar mjete financiare direkt nga MINT/KIESA në grant skemën për certifikimin e produkteve, nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga kjo thirrje. Po ashtu, gjatë vitit 2025, ndërmarrja e njëjtë nuk mundet të jetë përfituese e skemave të tjera, përveç skemës për shërbime të digjitalizimit.
- Në rast që ndërmarrja do të jetë përfitues, atëherë do të nënshkruhet marrëveshje dypalëshe (MINT/KIESA dhe ndërmarrje), pjesë e secilës do të jenë edhe deklaratimet që janë bërë me rastin e aplikimit.
- Për ndërmarrjet përfituese pas shpalljes së listës preliminare deri të realizimi i pagesës nuk lejohet asnjë ndryshim në ARBK.
- Para nënshkrimit të marrëveshjes, ndërmarrjet përfituese obligohen me sjell garancion nga kompanitë e sigurimit apo nga bankat, për vlerën totale të grantit.
- Pas nënshkrimit të marrëveshjes, ndërmarrjes përfituese do t'i transferohen 100% e vlerës së aprovuar.
- TVSH është shpenzim i pranueshëm për persona fizik dhe ndërmarrjet jo deklaruese të TVSH-së, ndërsa për ndërmarrjet që janë deklaruese të TVSH-së, ky është shpenzim i papranueshëm.

- Përfitues do të jenë ndërmarrjet që janë renditur më pikë më të larta nga komisioni vlerësues. Varësisht nga limitet buxhetore, lista e ndërmarrjeve përfituese mund të parasheh deri në 10 ndërmarrje rezervë.
- Ndryshimi i ofertës mund të bëhet vetëm me kërkesë të veçantë e cila parashtrahet në MINT/KIESA, respektivisht në komisionin monitorues. Kërkesa duhet të mbështetet në arsye të qëndrueshme nga përfituesi dhe e njëjta mund të implementohet vetëm pas miratimit të kërkesës dhe nuk ndryshohet koncepti i projektit dhe shuma e grantit nga Ministria. Në rastet kur kemi ofertues me çmime më të larta se ato të prezantuara në projektin aplikues, atëherë ndryshimet e çmimeve janë obligim i përfituesit dhe në asnjë rast nuk ndryshon vlera e grantit nga Ministria.
- Lista e ndërmarrjeve përfituese do të publikohet në faqet zyrtare të MINT dhe KIESA.
- Me këtë thirrje përjashtohen nga ky proces kompanitë konsulente që ofrojnë shërbime për ndërmarrjet aplikuese. Në rast të identifikimit të përfshirjes së tyre si përfaqësuese të ndërmarrjeve, aplikuesit do të diskualifikohen. Kjo për arsye se i gjithë procesi është i thjeshtë dhe pa kosto financiare, duke filluar nga mënyra elektronike e aplikimit përmes platformës e-Kosova, e deri të vlerësimi, nënshkrimi i marrëveshjeve, disbursimi i mjeteve dhe monitorimi i tyre.
- Ndërmarrjet përfituese në procesin e monitorimit, procesin certifikues duhet ta dëshmoj edhe me faturë origjinale.

6. Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e planifikuar maksimale për realizimin e plotë të projektit që financohet nga MINT/KIESA është 12 muaj, që nga nënshkrimi i kontratës ndërmjet palëve dhe nuk do të ketë aftat shtesë. Ndërmarrjet obligohen të raportojnë së paku 30 ditë para skadimit të marrëveshjes.

7. Si të aplikohet

- Njoftimi për thirrje publike është i publikuar në ueb faqen zyrtare të MINT dhe të KIESA-së: <https://mint.rks-gov.net> dhe <http://kiesa.rks-gov.net>
- Aplikimi bëhet vetëm përmes platformës e-Kosova <https://ekosova.rks-gov.net/501>
- Afati për aplikim: nga data 04.06.2025 deri më 25.06.2025.
- Informatat shtesë mund të merren përmes email adresës: sme.kiesa@rks-gov.net

#	8 Kriteret e vlerësimit	Pikët maksimale
1	Rëndësia e projekt propozimit për certifikimin ndërkombëtar të produktit	deri në 40 pikë
2	Qarkullimi i deklaruar dhe i dëshmuar nga ATK sipas pikës 13, të nenit 4 të këtij udhëzuesi	deri në 20 pikë
3	Potenciali për zgjerimin e tregut, ku synohet eksporti	deri në 20 pikë
4	Ndikimi Social dhe Ekonomik: Numri i vendeve të reja të punës të parashikuara për t'u krijuar gjatë dhe pas përfundimit të projektit.	deri në 20 pikë
#	Totali	deri në 100 pikë

9. **Ankesat:** Pas publikimit të rezultateve preliminare, aplikuesit mund të adresojnë ankesa brenda afatit të paraparë me UA 01/2018, vetëm në platformën e-Kosova.

Shënim: Nëse vërtetohet se informacionet e paraqitura në aplikacion janë të pasakta, përfituesit nuk do t'u bëhet pagesa dhe do të mbajnë përgjegjësi sipas legjislacionit në fuqi.